



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

VI
No. 2215 / 2026 - IN
Nr i Fa. 4
Br. Str.
No. Pg.
Data 22.05.2026
Datum
Date
Prishtinë / Pristina

GJYKATA SUPREME E KOSOVES
VRHOVNOG SUDA KOSOVA
DHOMA E POSAÇME
SPECIJALNA KOMORA

VERTETIMI MBI DOREZIMIN E DOKUMENTIT	POTVRDA O DOSTAVI DOKUMENTA	ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF A DOCUMENT
--	-----------------------------------	--

Numëri i lëndës:	C-IV-22-0144	Data:	15.05.2026
Titulli i dokumentit		Data e dokumentit	
AKTVENDIM		04.05.2026	
		H.S	

Pala	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT <i>Rr. Dritan Hoxha nr.55, Lakrishte, Prishtinë.</i>
Pranuar nga:	
Titulli:	
Data e pranimit:	
Nënshkrimi	





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2022:108721

Datë: 06.05.2026

Numri i dokumentit: 08862993

C-IV – 22-0144

Kërkesa: Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, Autoriteti i Likuidimit PRZ010 për NSH "Vreshtaria" (në likuidim) Fi. 696/50

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjyqtarin kryesues Hasim Sogojeva, dhe gjyqtarët anëtarë, Diellza Hoxha dhe Ganimete Puka në seancë vendimmarrëse më dt.04 maj 2026, merr këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet kërkesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në Prishtinë, Autoritetit të Likuidimit për NSH "VRESHTARIA" (në likuidim) dhe jepet pëlqimi që Agjencia Kosovare e Privatizimit të heq dorë nga aseti ngastra nr. P-71813061-00253, ZK Novakë, e regjistruar në emrin e N.SH. 'VRESHTARIA' (në likuidim), në dobi të autoritetit publik, Komuna e Prizrenit.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me dt. 20.05.2022, Agjencia Kosovare e Privatizimit, ka ushtruar kërkesë në DHPGJS, për të kërkuar nga gjykata për të hequr dorë nga aseti P-71813061-00253 e sipërfaqe 1335 m², ZK Novakë, që është regjistruar në emër të NSH "Vreshtaria" (likuidim).

Parcela me numër P-71813051-00253-3 K Novakë me sipërfaqe prej 1335 m² me kulturë "bujqësore-kullosë e klasës 4" në terren është evidentuar si rrugë e pa asfaltuar, që është pronë e NSH "Vreshtaria" është hequr nga shitja për shkak se në terren është evidentuar si rrugë publike. Për këtë arsye, Autoriteti i Likuidimit kërkon leje për të hequr dorë (abdikuar) nga aseti P-71813061-00253-3.

Tutje ka theksuar se duke pasur parasysh që parcela nr. P-71813061-00253-3 ZK Novakë me sipërfaqe prej 1335 m² shfrytëzohet si rrugë, Autoriteti i Likuidimit erdhi në përfundimin që aseti nuk është në gjendje realizimi fitimprurës dhe tashmë ka marrë miratimin nga Bordi | Drejtorëve të Agjencisë për të hequr dorë nga aseti. Përveç kësaj, në pajtim me nenin 11 të Ligjit nr. 2003/11

për Rugët "Asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike". Pas aprovimit të kësaj kërkesë të Autoritetit të Likuidimit nga ana e DHPGJS, atëherë në përputhje me nenin 42 par.2 të Ligjit Nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, i cili specifikon që "Në qoftë se hiqet dorë nga pronësia në një paluajtshmëri, atëherë pronësinë në atë paluajtshmëri e fiton subjekti publik kompetent në territorin e të cilës ndodhët paluajtshmëria" pronësia mbi këtë aset do të kalojë mbi organin publik kompetent.

Duke u bazuar në faktet dhe arsyet të paraqitura si më lart, Autoriteti Likuidimit kërkon Dhomës së Posaçme të marrë lejen për të hequr dorë nga aseti me sipërfaqe prej 1335 m², siç përshkruhet në certifikatën nr. 07-942-05-178019 e datës 09.11.2021.

Ka bashkangjitur:

- Raporti i vizitës nga tereni me fotografi i datës 21.04.2022.
- Raporti i gjendjes së Proceseve të Ndërmarrjes Shoqërore.
- Njoftimi i publikuar në gazetën ditore „Kosova Sot”,
- Vendimi për emërimin e anëtareve të Autoritetit të Likuidimit datë 09.07.2014.
- Certifikata për njësinë kadastrale P- 71813061-00253-3 e sipërfaqe 1335 m², ZK Novakë.
- Kopja e Planit e lëshuar nga Agjencia Kadastrale në Prizren.
- Kërkesa e AKP-së për Komunën e Prizrenit lidhur me konfirmimin që kanë të bëjnë me asetet e N.SH. ‘Vreshtaria’.
- Konfirmimi i lëshuar nga Kryetari i Komunës së Prizrenit për asetet e N.SH. ‘Vreshtaria’ e datës 11.05.2022 nr. 077/22.
- Vendimi Ref. BD – 162/24 dt. 28.04.2022, i AKP-së.
- Memorandumi për Bordin e Drejtorëve , të AKP-së.

Arsyetimi ligjor

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës e jep pëlqimin për AKP, për të hequr dorë nga aseti P- 71813061-00253-3 e sipërfaqe 1335 m², ZK Novakë, Komuna e Prizrenit që është regjistruar në emër të NSH “Vreshtaria” (likuidim).

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, ka juridiksion për të vendosur në bazë të nenit 5 të Ligjit nr. 06/L-086 Për DHPGJSK për Agjencinë Kosovare të Privatizimit për Ndërmarrjet apo Korporatat të cilat i nënshtrohen autoritetit administrativ të AKP-së .

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, vlerëson se për rastin konkret Agjencia Kosovare e Privatizimit / Autoriteti i Likuidimit në kërkesën e saj për aprovimin e lejes për të hequr dorë nga aseti i NSH “Vreshtaria” me nr. P- 71813061-00253-3 e sipërfaqe 1335 m², ZK Novakë, që është regjistruar në emër të NSH “Vreshtaria”, ka caktuar zyrtaret e saj për të vizituar gjendjen faktike në teren lidhur me ngastrën lëndore, ka hartuar një raport me shkrim dhe ka konstatuar se ngastra kadastrale nr. P- 71813061-00253-3 e sipërfaqe 1335 m², ZK Novakë, me kulturë ‘bujqësore – kullosë e klasës 4’, ndërsa sipas gjendjes faktike në teren është rrugë e cila nuk është e asfaltuar por që lidhet me rrugë të tjera lokale.

Duke pasur parasysh faktin se në gjendjen faktike të ngastrës -asetit, e njëjta shfrytëzohet si rrugë e cila nuk është e asfaltuar por që lidhet me rrugë të tjera lokale, gjykata pranon qëndrimin

e Bordit të AKP-së, se aset i nuk mund të jetë fitimprurës për NSH -në, pasi në gjendje aktuale që është ngastra, AKP nuk do të mund të përdoret për realizim të hyrave në dobi të NSH-së, kështu që në rastin konkret Dhoma jep pëlqimin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit për heqje dorë nga ky aset, në dobi të autoritetit publik, Komunës.

Me dispozitën e nenit 18, paragrafi 3, të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, është paraparë "Autoriteti i Likuidimit, me leje të Gjykatës, mund të heq dorë apo në mënyra tjera të zgjidh cilindo nga asetet e ndërmarrjes në vijim:

3.1 çdo aset problematik apo jo profitabil i cili, sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit të Likuidimit, nuk është në gjendje të ketë realizim fitimprurës,

3.2 çdo aset që sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit të Likuidimit nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e ndërmarrjes, Autoritetit të Likuidimit apo Gjykatës''

Me rastin e dhënies së pëlqimit për heqje dorë nga aset i, gjykata vlerësoi se janë përmbushur kriteret që parasheh dispozita e nenit 18, paragrafi 3 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Për këtë arsye u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për Dhomën e Posaçme vendosi që shpenzimet e procedurës ti heqë.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë, me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh, nga pranimi i këtij aktvendimi.

Hasim Sogojeva, Gjyqtar Kryesues

Diella Hoxha, Gjyqtare anëtare

Ganimete Puka, Gjyqtar anëtarë

